

UDHËZUES PËR AUTORËT

HAPAT QË DUHET TË NDIQEN PËR PARAQITJEN E ARTIKULLIT

1. Gjuha e dokumentit: Të gjitha punimet duhet të dorëzohen në gjuhën shqipe dhe angleze.
2. Punimi i plotë duhet të jetë ndërmjet 3000 - 4000 fjalë (10-12 faqe, duke përfshirë shembuj muzikorë, tabela, figura dhe referenca).
3. Struktura duhet të jetë si më poshtë:
 - Abstrakti;
 - Hyrja;
 - Rishikimi i literaturës;
 - Metodologjia;
 - Rezultatet dhe diskutimet;
 - Përfundimet dhe rekomandimet/Pritshmëritë;
 - Referencat;
 - Shtojcat.
4. Abstrakti dhe punimi i plotë duhet të dërgohen në adresën e emailit conference@uart.edu.al duke specifikuar gjithashtu fushën e përzgjedhur;
5. Të gjitha abstraktet dhe punimet do t'i nënshtrohen peer review (kontrollit nga kolegët) dhe duhet të plotësojnë standardet e ekselencës akademike.
6. Autorët do të njoftohen me e-mail, duke përdorur adresën e deklaruar. Ata që nuk marrin konfirmimin brenda datës së caktuar, duhet të kontaktojnë në adresën e emailit conference@uart.edu.al;
7. Prezantimi në konferencë mund të bëhet personalisht ose online.

UDHËZIM PËR DORËZIMIN E ABSTRAKTIT

Abstrakti duhet të jetë i shkurtër, të tregojë qëllimin/rëndësinë e hulumtimit dhe të përmbajë 250-300 fjalë. Abstrakti duhet të jetë një paragraf i vetëm dhe duhet të ndjekë stilin e abstrakteve të strukturuar, por pa tituj. Ai duhet të përfshijë: Hyrjen, Rishikimin e literaturës, Metodologjinë, Rezultatet dhe diskutimet, Përfundimet dhe rekomandimet/Pritshmëritë.

Lutemi, të mos përdoren simbole, karaktere të veçanta apo shënime në fund të faqes në titullin e punimit dhe në abstrakt.

- **Titulli i artikullit:** Times New Roman, sentence case, font size 14, centred paragraph, bold.
- **Emri i autorit:** ¹Autori parë, A. A., ²Autori dytë, B. B., ³ I treti, C. C e kështu me radhë. adresat e emailit të autorit (1) përkatësia e autorit/autorëve (Institucioni, Shteti)[Times New Roman, 12, centred paragraph]
- **Përmbajtja:** Teksti i Abstraktit duhet të përmbajë deri në 250 -300 fjalë, shkrimi Times New Roman 12, Italics. Page Margins duhet të jenë 2,5 cm në të katër anët. Paragrafët duhet të jenë Justified (straight-edged) si në të majtë ashtu edhe në të djathtë. Përdorni hapësirën 1,5 ndërmjet rreshtave dhe lini një rresht bosh midis paragrafëve.

Abstrakti duhet të përfshijë problemin e hulumtimit, qëllimin dhe objektivat e studimit, pyetjet e hulumtimit, hipotezat, metodologjinë (qasja e hulumtimit, popullata dhe kampioni, instrumentet), rezultatet dhe diskutimet si dhe përfundimet.

Abstraktet që nuk plotësojnë këto kërkesa të formatimit nuk do të pranohen dhe do të kthehen.

- **Fjalë kyçe** [Majtas, Times New Roman, font size 12, bold, italics]: Shkruani 3 deri në 5 terma kyçe që nuk përmenden në titullin e punimit, të ndara me presje (.). [Majtas, Times New Roman, font size 12, italics]
- **Formati**: Abstrakti duhet të dorëzohet në formatin Microsoft Word (97-2003 document).

UDHËZIM PËR DORËZIMIN E PLOTË TË PUNIMIT

Punimi duhet të dorëzohet në formatin Microsoft Word (97-2003 document) me cilësimet e mëposhtme:

- Gjuha e dokumentit duhet të jetë në gjuhën shqipe dhe angleze.
- Punimi duhet të ketë 3-5 fjalë kyçe.
- Punimi duhet të ketë jo më pak se 15 referenca.
- Stili i të shkruarit do të jetë si më poshtë:
 - Font: *Times New Roman*
 - Font Size: *12*
 - Line Spacing: *1.5*
 - Paper size *A4*
- Citimi dhe referimi në tekst: stili i referimit APA Style Edition 7th, (American Psychological Association).
- Numri i faqeve duhet të vendoset në këndin e poshtëm djathtas të faqes.